



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr. 02/L-36

PËR DUHANIN

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të kompetencave të dhëna Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës nga Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara Misioni në Kosovë (UNMIK) me Rregulloren Nr. 2001/9 të datës 15 Maj 2001, "Mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë;

Bazuar në Ligjin për Shëndetësi të Kosovës;

Me qëllim të vënies së bazës ligjore për rregullimin, përparimin dhe përmirësimin e gjendjes shëndetësore të qytetarëve të Kosovës, nëpërmjet përmirësimit të sistemit të financimit të kujdesit shëndetësor.

Miraton:

LIGJIN PËR DUHANIN

I. Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1

1.1. Qëllimi i këtij Ligji është të mbështesë përpjekjet e shoqërisë për të zbutur dhe reaguuar ndaj një problemi të madh të shëndetësisë publike, në veçanti:

- i. të mbroj shëndetin e popullsisë posaçërisht pas evidentimit dhe vërtetimit shkencor të implikimit të duhanit në shtimin e incidencës së shumë sëmundjeve të rrezikshme për jetë;
- ii. të mbroj fëmijët, të rinjët dhe të tjerët, nga shkaqet që mundësojnë përdorimin e prodhimeve të duhanit dhe varshmërisë prej tyre;
- iii. të ngrit nivelin e njohurive dhe të vetëdijësoj popullatën për rrezikshmërinë e përdorimit të duhanit duke siguruar komunikimin efektiv dhe informativ;
- iv. të mbroj popullatën, në masën që është e mundur, nga rreziku i ekspozimit jo të vullnetshëm ndaj tymit të duhanit; dhe
- v. të rregulloj dhe kontrolloj prodhimet e duhanit dhe shpërndarjes së tyre në pajtueshmëri me synimet e shëndetit publik.

1.2. Ky Ligj përcakton masat për kufizimin dhe ndalimin e pirjes së duhanit në vende publike, përbërjes së dëmshme të cigareve, vendosjen obligative të shënimit për dëmet nga pirja e duhanit dhe mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së këtij ligji.

II. Përkufizimet

Neni 2

Termat e përdorura në këtë Ligj kanë këto kuptime:

Duhani, nënkupton bimën e familjes Nicotiniana të llojeve dhe tipeve të ndryshme të modifikuar apo jo të modifikuar gjenetikisht, me gjithë pjesët e saj.

Prodhimet e duhanit, nënkuptojnë prodhimet e bëra vetëm nga duhani (të modifikuara apo të pamodifikuara gjenetikisht) apo pjesërisht nga duhani e që përdoren për të pirë, tërheq me hundë, thithë apo përtypë,

Duhani për përdorim oral, nënkuptojnë gjitha prodhimet e bëra vetëm nga duhani (të modifikuara apo të pamodifikuara gjenetikisht) apo pjesërisht nga duhani e që përdoren përmes gojës por jo për të u pirë,

Katrani, nënkupton mbetjen e thatë të tymit të duhanit pa nikotinë.

Nikotina, është alkaloid helmues i cili gjindet në duhan dhe ka veprim helmues në sistemin nervor autonom.

Përbërësi, nënkupton çdo lloj substance apo elementi, përveç çfarëdo pjese të bimës së duhanit natyral të pa procesuar që përdoret në prodhimin e produkteve të duhanit e që është i pranishëm në prodhimin final edhe në qoftë se është në formë të ndryshuar duke futur këtu edhe letrën, filtrin, ngjyrat dhe ngjitësin.

Pirja e duhanit, në kuadër të këtij Ligji nënkupton përdorimin e prodhimeve të duhanit pa marrë parasysh se tymi i cigares i lëshuar me djegien e sajë thithet në mënyrë aktive apo pasive, e ka si pasojë dëmtimet e vërtetuara të shëndetit të duhanpirësve aktive dhe pasive të cilët janë të ekspozuar tymit të duhanit,

Për pasojat e dëmshme, të pirjes së duhanit janë dëshmitë shkencore të dëmtimit të shëndetit, sëmundjet të cilat shkurtojnë jetën e duhangjinjëve dhe të joduhangjinjëve nëse qëndrojnë në hapësirën e njëjtë të mbyllur ku pihet duhani.

Masat preventive kundër pirjes së duhanit, janë veprimet të cilat kanë për qëllim ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit si dhe ngritjen e cilësisë të jetës së qytetarëve.

Vendi publik, nënkupton hapësirën e mbyllur e cila dedikohet qëndrimit të dy apo më shumë njerëzve dhe përfshinë hapësirat në të cilat kryhen aktivitetet nga lëmia e shëndetësisë dhe asaj sociale, edukimit dhe arsimimit, sportit e rekreacionit, lokaleve hoteliere e shërbyese, kulturës dhe artit, hapësirave për pritje, mbledhje e takime, vende të punës me pronësi publike ose private, të gjitha sallat për tubimin e njerëzve, mjetet e transportit publik. Terrasat e hapura, ballkonet, nuk nënkuptohen vende publike.

ISO, Organizata Internacionale për Standardizim ISO është rrjet i institucioneve kombëtare standardizuese nga 148 vende me qendër në Gjenevë, Zvicër.

III. Kushtet e domosdoshme

Neni 3

3.1. Ndalohet prodhimi dhe qarkullimi i cigareve të cilat përmbajnë:

1. Më shumë se 10 mg katran për një cigare,
2. Më shumë se 1 mg nikotin për një cigare,
3. Më shumë se 10 mg monoksid të karbonit për një cigare.

3.2. Prodhimi dhe qarkullimi i cigareve me përmbajtje nga pika 1 e nenit 3 është e obliguar nga 1 Janari 2005.

Neni 4

4.1. Qeveria e Kosovës, apo Institucioni i autorizuar nga ajo, mbështetur në të dhënat shkencore, mban të drejtën të ndaloj përdorimin e përbërësve të ndryshëm në prodhimet e duhanit e veçanërisht përbërësve që shkaktojnë mvarësi.

4.2. Të gjitha prodhimet e duhanit që prodhohen apo importohen dhe dalin në tregun e Kosovës duhet të testohen.

4.3. Testimet për katranin, nikotinën dhe monoksidin e karbonit për një cigare bëhet në laboratorët e licencuara nga Ministria e Shëndetësisë. Rezultatet e testeve raportohen Ministrisë së Shëndetësisë sipas ndarjes kohore të përcaktuar nga kjo Ministri.

4.4. Qeveria e Kosovës mban të drejtën të kërkoj nga prodhuesit apo importuesit e duhanit teste shtesë për të parë prezencën dhe përqendrimin e substancave tjera që nuk janë përfshirë në pikën 4.3 të nenit 4.

4.5. Testimet për substancat e përfshira në pikën 3 të nenit 4 duhet të bëhen me standardet e përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë përmes zbatimit të standardeve ISO. Duhet të përdoren këto standarde, ISO standardi 4387 për katranin, 10315 për nikotinën dhe 8454 për monoksidin e karbonit. Saktësia e paraqitjes së sasisë së katranit dhe nikotinës në paketim verifikohet përmes ISO standardit 8243.

4.6. Testimet dhe rezultatet e testeve bëhen dhe dorëzohen në afat kohor që përcakton Ministria e Shëndetësisë.

4.7. Çdo ndryshim i përbërjes kimike të prodhimeve të duhanit nga një prodhues apo importues duhet të paraqitet në Ministrinë e Shëndetësisë nga prodhuesi apo importuesi i prodhimeve të duhanit.

4.8. Në qoftë se laborator i licencuar dëshmon se përbërja e mostrës të marrë nga një seri e prodhimeve të duhanit nuk i përmbahet vlerave të parapara me ligj, atëherë e tërë ajo seri duhet të tërhiqet nga tregu.

4.9. Institucion i autorizuar nga Qeveria e Kosovës do të mbikëqyrë rregullshmërinë e shenjave dhe përbërjes së prodhimeve të duhanit që prodhohen apo importohen dhe shiten në tregun e Kosovës.

Neni 5

5.1. Prodhimet e duhanit që shiten në tregun e Kosovës duhet të kenë shenja në pajtueshmëri me procedurat e parapara me aktet ligjore.

5.2. Çdo lloj paketimi individual i prodhimeve të duhanit që prodhohet apo importohet dhe qarkullon e shitet në tregun e territorit të Kosovës duhet të përmbajë këto të dhëna:

- a. Sasia e nikotinës,
- b. Sasia e katranit,
- c. Sasia e monoksidit të karbonit,
- d. Numrin serik apo ekuivalent të saj,
- e. Emrin dhe adresën e prodhuesit apo importuesit,
- f. Numrin e njërive në paketime individuale të prodhimeve të duhanit,
- g. Emri dhe adresa e paketuesit, në raste kur prodhuesi nuk e ka bërë paketimin vetë.

5.3. Çdo lloj paketimi dhe çdo lloj informatë e prezantuar për prodhime të duhanit duhet të mos jep përshtypje të gabueshme për karakteristikat e duhanit dhe efektet e saj në shëndetin e njeriut duke përfshirë këtu edhe informata që një lloj i prodhimeve të duhanit është më pak i dëmshëm se lloji tjetër. Prandaj, ndalohet të përdoren në çfarëdo lloji të paketimit të duhanit fjalët si “e lehtë”, “shumë e lehtë”, “e butë”, “pak katran” dhe fjalë apo informata të ngjashme.

Neni 6

6.1. Çdo lloj paketimi dhe marketingu i prodhimeve të duhanit duhet të ketë informata për pasoja negative në shëndetin e njeriut nga përdorimi i duhanit.

6.2. Çdo njësi e paketimit të prodhimeve të duhanit duhet të ketë këto vërejtje:

- a) Vërejtje të përgjithshme:
 - I. "Pirja e duhanit vret" ose
 - II. "Pirja e duhanit dëmton seriozisht shëndetin e Juaj dhe të rrethit Juaj";
- b) Vërejtjet shtesë siç janë:
 - I. “Duhani dëmton shëndetin e juaj”
 - II. “Pirja e duhanit shkakton kancerin”
 - III. “Pirja e duhanit të shtatzënat dëmton zhvillimin e fëmijës”
 - IV. “Pirja e duhanit shkakton infarktin dhe sulm në tru”
 - V. “Pirja e duhanit shkurton jetën e juaj”
 - VI. “T’i mbrojmë fëmijët: mos lejoni ta thithin tymin e cigares tuaj”.

6.3. Vërejtja e përgjithshme dhe ajo shtesë duhet të paraqitet në atë mënyrë që gjatë rrotullimit të paketimit prezantimi i vërejtjeve të paraqitet rregullisht.

6.4. Vërejtja e përgjithshme shtypet në sipërfaqen më të dukshme të njësisë së paketimit dhe në çfarëdo lloj paketimi përveç mbështjellësve të tejdukshëm.

6.5. Vërejtja shtesë shtypet në sipërfaqe tjetër më të dukshme të njësisë së paketimit dhe në çfarëdo lloj paketimi përveç mbështjellësve plotësisht të tejdukshëm.

6.6. Vërejtja e përgjithshme duhet të përfshijë së paku 30 % të sipërfaqes së jashtme të paketimit individual. Ndërsa, kur shtohet edhe vërejtja shtesë përqindja e përfshirjes së sipërfaqes së jashtme duhet të jetë së paku 50 %.

6.7. Teksti i vërejtjeve dhe sasisë së nikotinës, katranit dhe monoksidit të karbonit duhet të:

- i. shtypet me fontin e zi të Helvetikës të trash në sfond të bardhë. Madhësia e fontit duhet të jetë e tillë që teksti të mbuloj pjesën më të madhe të sipërfaqes së paraparë për vërejtjen;
- ii. të jetë me shkronja të vogla përveç shkronjës së parë dhe duke respektuar rregullat e drejtshkrimit;
- iii. të vendoset në mënyrë qendrore paralelisht në skajin e sipërm të paketimit;
- iv. teksti kufizohet me një vijë me trashësi 3 deri në 4 mm e që nuk takon apo gërsheton tekstin e vërejtjes apo të informative tjera;
- v. teksti duhet të jetë në gjuhë/t zyrtare.

6.8. Shtypja e tekstit të vërejtjes nuk lejohet të bëhet në banderolën taksative të paketimit.

6.9. Teksti i shtypur duhet të jetë i pashlyeshëm dhe që nuk mundet të hiqet pa u dëmtuar teksti, dhe në asnjë mënyrë të jetë i fshehur me shtypje tjera në njësi të paketimit apo të hiqet ose dëmtohet gjatë hapjes së paketimit.

6.10. Paketimi duhet të shënohet me numër serik apo metodë tjetër të përshtatshme që bënë të mundshëm përcaktimin e lehtë të vendit dhe kohës së prodhimit të duhanit.

6.11. Ministria e Shëndetësisë mban të drejtë të ndryshoj apo shtojë vërejtjet e përgjithshme dhe ato shtesë.

Neni 7

7.1. Prodhuesit dhe importuesit e prodhimeve të duhanit duhet t'u paraqesin organeve përgjegjëse listën e gjithë përbërësve dhe sasive të tyre që përdoren gjatë prodhimit të produkteve të duhanit së paku njëherë brenda vitit kalendarik.

7.2. Listës duhet t'i bashkëngjiten arsyet e futjes së këtyre përbërësve në prodhimet e duhanit. Duhet theksuar funksionin dhe kategorinë e përbërësve.

7.3. Lista, gjithashtu duhet të shoqërohet nga të dhënat toksikologjike nga prodhuesi apo importuesi për përbërësit e prodhimeve të duhanit, duke u referuar veçanërisht në efektet e tyre në shëndet dhe në vetitë e tyre për të shkaktuar mvarësi.

7.4. Përbërësit e duhanit duhet të renditen në listë sipas peshës së tyre.

7.5. Duhet të mbrohet çfarëdo informate që ka të bëjë me formulë specifike të prodhimit e që paraqet sekret tregu.

7.6. Organet kompetente duhet të bëjnë publike informatat të mara nga prodhuesit dhe importuesit e prodhimeve të duhanit duke ia bashkëngjitur këtu edhe listën e përbërësve për secilin prodhim dhe sasinë e katranit, nikotinës dhe monoksidit të karbonit.

IV. Masat për zvogëlimin dhe kufizimin e pirjes së duhanit

Neni 8

- 8.1. Ndalohet reklamimi dhe promovimi në çfarëdo forme i prodhimeve të duhanit nga çdo person fizik apo juridik.
- 8.2. Asnjë person nuk mund të reklamojë prodhimet e duhanit në çfarëdo forme në emër të ndonjë personi tjetër fizik apo juridik.
- 8.3. Shitësit që nuk i është ndaluar shitja e prodhimeve të duhanit mundet të vendos këto prodhime në hapësirën afariste të shitësit duke respektuar ligjet në fuqi, mund të vendos vetëm informata se në atë hapësirë afariste shiten prodhime të duhanit vetëm nëse këto informata janë të shoqëruara me informata shëndetësore në përputhje me këtë dhe ligjet tjera. Nuk duhet të ketë informata që promovojnë apo japin të dhëna tjera në lidhje me këto prodhime të duhanit. Vendosja e prodhimeve të duhanit në pikën e shitjes duhet të jetë e fshehur nga publiku i përgjithshëm jashtë pikës se shitjes.
- 8.4. Ndalohet sponsorimi i çfarëdo lloji nga ndërmarrjet aktiviteti kryesor i të cilave është prodhimi apo shitja e prodhimeve të duhanit.
- 8.5. Ndalohet shitja apo ofrimi i prodhimeve të duhanit nga personat më të rinj se 18 vjet.
- 8.6. Ndalohet shitja e duhanit jashtë objekteve të lejuara të shitjes.

V. Shitja e prodhimeve të duhanit

Neni 9

- 9.1. Shitja apo ofrimi i prodhimeve të duhanit nuk lejohet në:
 - a) gjitha llojet e institucioneve dhe organizatave shëndetësore,
 - b) shkolla, kolegje dhe universitete dhe institucionet tjera arsimore,
 - c) gjitha llojet e objekteve sportive, rekreative dhe kulturore,
 - d) vendet ku ndalesa kërkohet me rregullore apo ligje tjera.
- 9.2. Shitja apo ofrimi i duhanit ndalohet të bëhet përmes:
 - a) makinave automatike shitëse,
 - b) vendeve dhe metodave vetë shërbyese,
 - c) përmes shërbimeve postare dhe mediave komunikuese të çfarëdo forme apo
 - d) mënyra tjera të definuara me rregullore apo ligje tjera.
- 9.3. Çdo shpërndarës apo shitës i prodhimeve të duhanit duhet të ketë licencë për shpërndarje dhe shitje të produkteve të duhanit.
- 9.4. Licenca nga pika 9.3 e nenit 9 lëshohet nga organi i autorizuar nga Qeveria e Kosovës.
- 9.5. Ndalohet shitja apo ofrimi i prodhimeve të duhanit për përtypje dhe për tërheqje me hundë.
- 9.6. Ndalohet shitja e prodhimeve të duhanit personave më të rinj se 18 vjeç.

9.7. Në të gjitha vendet shitëse të prodhimeve të duhanit duhet të vendosen shenjat e ndalimit të shitjes së duhanit personave më të rinj se 18 vjeç. Shenja nga pika 9.5 e nenit 9 duhet të jetë e vendosur në vend që shihet dhe lexohet nga largësia më së paku 5m.

9.8. Ndalohet shitja e prodhimeve të duhanit jashtë paketimit origjinal të prodhuesit apo importuesit.

VI. Ndalimi i pirjes duhanit

Neni 10

10.1. Ndalohet pirja e duhanit në të gjitha institucionet publike apo private ku ofrohen shërbime shëndetësore.

10.2. Ndalohet pirja e duhanit në të gjitha institucionet publike apo private të edukimit, arsimit dhe të mbikëqyrjes së fëmijëve dhe rinisë.

10.3. Ndalohet pirja e duhanit në hapësirën publike, përveç në ato hapësira të parapara për pirje të duhanit.

10.4. Në hapësirat publike, përveç vendeve të përcaktuara nga pika 10.1 dhe 10.2 të nenit 10, mundet të sigurohen vende për pirjen e duhanit, por që këto vende nuk janë vendqëndrime të zakonshme për personat që nuk pinë duhan apo që nuk është e nevojshme dhe e domosdoshme të vizitohen gjatë kohës së punës.

10.5. Hapësira e dedikuar për pirje të duhanit nuk guxon të jetë më e madhe se 30% nga hapësira e lokalit gjegjës.

10.6. Përcaktimin e hapësirës për duhangjinjë duhet të bëhet nga personi përgjegjës juridik apo fizik i hapësirës në fjalë.

10.7. Hapësira për duhangjinjë duhet të jetë e pajisur me aparate për ajrosje, take-tuke dhe me mjete kundër zjarrit.

10.8. Personi përgjegjës i hapësirës publike mund të ndalon pirjen e duhanit në të gjithë hapësirën, për çka duhet shënuar me mbishkrim në hyrje të atij objekti si dhe në vendet ku shihen në mbrendi të sajë.

10.9. Personi përgjegjës i hapësirës publike duhet të vendos shenjat e lejitimit apo mos lejitimit të pirjes së duhanit në vendet që shihen dhe që mund të lexohen nga largësia prej 5m.

10.10. Në vendet publike dhe në vendet e punës me pronësi private apo publike ku është e ndaluar pirja e duhanit nuk duhet të jenë të vendosura take-tuket.

10.11. Qeveria mban të drejtën që të kërkoj kushte tjera shtesë për hapësirat ku lejohet pirja e duhanit.

VII. Masat preventive kundër pirjes së duhanit

Neni 11

11.1. Të gjitha institucionet që merren me edukimin dhe arsimimin e fëmijëve dhe të rinjve obligohen që të ndërmarrin aktivitete që promovojnë vetëdijesimin e popullatës së re mbi dëmet që shkakton pirja e duhanit.

11.2. Në realizimin e kujdesit për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve nga ndikimi i dëmshëm i pirjes së duhanit, Qeveria e Kosovës formon këshillin profesional për kontrollin e duhanit.

11.3. Këshilli duhet të ketë 11 deri në 15 anëtarë ku do të përfshihen: përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, Ekonomisë dhe Financave, Mbrojtjes së Mjedisit, Shëndetësisë, Rinisë e Sportit, mjekë, përfaqësues të mjeteve të informimit dhe nga shoqëria civile.

VIII. Mbikëqyrja

Neni 12

12.1. Mbikëqyrjen e zbatimit të këtij Ligji e kryen Inspektorët qendror dhe komunal, secili në fushën e vet: Inspektorët sanitarë, shëndetësorë, të punës, të tregut dhe të arsimit. Detyrat, të drejtat dhe përgjegjësit e inspektorëve përcaktohen me ligje specifike për inspektim të fushave përkatëse.

12.2. Inspektorët sanitarë kryejnë mbikëqyrjen e zbatueshmërisë të neneve: 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, dhe 11 të këtij Ligji.

12.3. Inspektorët shëndetësor kujdesen për zbatimin e nenit 9 të këtij Ligji.

12.4. Inspektorët e tregut kujdesen për zbatimin e nenit 9 të këtij Ligji.

12.5. Inspektorët e punës kujdesen për zbatimin e nenit 9 dhe 10 të këtij Ligji.

12.6. Inspektorët e arsimit mbikëqyrin zbatimin e nenit 10, dhe 11 të këtij Ligji.

12.7. Për të mbikëqyrë pikën 6 të nenit 9, organi i autorizuar nga Qeveria e Kosovës mund të caktoj personat që janë më të rinj se 18 vjeç për inspektim.

12.8. Çdo person i caktuar për inspektim nën moshën 18 vjeçe është i obliguar të veproj nën mbikëqyrjen e inspektorit më të vjetër se 18 vjet.

IX. Dispozitat ndëshkuese

Neni 13

13.1. Në rastet kur inspektori përgjegjës konstaton se duhani shitet në kundërshtim me dispozitat e të këtij Ligji, inspektori personit juridik apo fizik i cili bën shitjen e duhanit me vendim ia ndalon shitjen e mëtutjeshme

13.2. Gjobitet në vlerë prej 5.000–10.000 Euro personi juridik i cili:

- i. prodhon apo importon prodhimet e duhanit në kundërshtim me nenin 3, 4, 5, 6, dhe 7 të këtij Ligji,

- ii. reklamon apo promovon prodhimet e duhanit në kundërshtim me nenin 8 të këtij Ligji,
- iii. sponsorizon në kundërshtim me nenin 8 të këtij Ligji,
- iv. shet apo ofron prodhimet e duhanit në kundërshtim me nenin 9 të këtij Ligji,
- v. lejon pirjen e duhanit në hapësira publike në kundërshtim me nenin 10 të këtij Ligji

13.3. Gjobiten personat fizik që pinë duhan në vend të punës në kundërshtim me nenin 10 me zbritje prej 5% të pagës neto mujore

13.4. Në vlerë prej 3.000–5.000 Euro gjobiten personat juridik nëse:

- i. nuk e ven në vend që shihet mbishkrimin mbi ndalimin e shitjes së duhanit personave më të rinj se 18 vjeç,
- ii. nuk e ven në vend që shihet mirë mbishkrimin siç parashihet me nenin 10 të këtij Ligji,
- iii. nuk i paraqet shenjat e ndalimit të pirjes së duhanit në institucionet shëndetësore, edukative e arsimore dhe mbikëqyrëse, në përputhshmëri me nenin 10 të këtij Ligji.

13.5. Në vend të ngjarjes inspektori i autorizuar gjobit qytetarin në vlerë prej 20 Euro për kundërvajtje, nëse:

- i. qytetari pinë duhan në objektet shëndetësore, arsimore e edukative dhe mbikëqyrëse, në kundërshtim me nenin 10 të këtij Ligji,
- ii. qytetarin e takon duke pirë duhan në vend publik, në hapësirën që nuk është e parapare për pirje të duhanit në kundërshtim me nenin 10 të këtij Ligji.

X. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 14

14.1. Prodhuesit dhe importuesit të prodhimeve të duhanit janë të obliguar që në afat prej 6 muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji të vendosin shenjzimet në paketimet e prodhimeve të duhanit të përcaktuar në bazë të këtij Ligji.

14.2. Institucionet dhe organizatat e gjitha llojeve janë të obliguar që në afat prej 4 muajsh të vendosin shenjat e ndalesës së pirjes së duhanit dhe të përcaktojnë vendet ku mund të pihet duhani në qoftë se përcaktohen që të kenë këso vende, pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 30 ditë pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Ligji Nr. 02/L-36
3 tetor 2005

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

akademik Nexhat Daci